



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Tiranë, më 29.06. 2019

NJOFTIM PËR MEDIAN

Sipas informacionit që u administrua nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, deri në këtë moment, rezulton se numri i përgjithshëm i çështjeve të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira në funksion të fushatës së zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019, është gjithsej **12 (dymbëdhjetë) procedime me 75 (shtatëdhjetë e pesë) persona të arrestuar/ ndaluar. Konkretisht:**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Elbasan**, ka regjistruar, **2 (dy) procedime** penale që lidhen me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira:
 - Procedimi penal nr. 1183 datë 14.06.2019, me **7(shtatë) persona të arrestuar** nga policia gjyqësore për veprat penale, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe “Pengimi i subjekteve zgjedhore”, parashikuar respektivisht nga nenet 262, 293, 325 e 25 të Kodit Penal,
 - Procedimi penal nr. 1250 datë 26.06.2019, për veprën penale “Thirrjet publike për veprime të dhunshme”, parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal me **1 (një) person** nën hetim;
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Shkodër**, ka regjistruar **3(tre) procedime** penale, që lidhen me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira:
 - Procedimi penal i vitit 2019 për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr i pronës” e parashikuar nga neni 152/1 i Kodit Penal dhe “Kundërshtimi i punonjësit të policisë” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Për këtë procedim janë **arrestuar 5(pesë) persona**, ndërsa **2 (dy) persona janë ndaluar me iniciativë** nga policia gjyqësore. Sa ju përket masave të sigurimit, rezulton se **4 (katër)** janë me masë sigurimi “**arrest në**

burg”, 2 (dy) me masë sigurimi “arrest shtëpie”, dhe 1 (një) person me masë sigurimi “detyrim për paraqitje”.

- Procedimi penal nr. 983 i vitit 2019 i regjistruar për veprat penale “Dëmtimi me dashje i materialeve zgjedhore”, parashikuar nga neni 326/a/1 i Kodit Penal dhe “Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Lidhur me këtë procedim penal janë **arrestuar 14 (katërmëdhjetë)** persona. Akoma nuk janë dhënë masat e sigurimit nga gjykata.
 - Procedimi penal nr. 987 viti 2019 i regjistruar për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, dhe “Dëmtimi me dashje i materialeve zgjedhore” parashikuar nga neni 326/a/1 i Kodit Penal. **Nuk ka** akoma persona nën hetim.
3. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Tiranë**, më datë 21.06.2019, ka regjistruar **1 (një) procedim penal** në ngarkim të **3 (tre) personave të arrestuar në flagrancë**, të dyshuar për kryerjen e veprën penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor” parashikuar nga neni 326/a/2 të Kodit Penal.
 4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Tropojë** më datë 19.06.2019, ka regjistruar **1 (një) procedim penal**, nr.91, në ngarkim të **7 (shtatë) personave të arrestuar në flagrancë dhe 2 (dy) personave të ndaluar**, për kryerjen e veprave penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestim të paligjshme” parashikuar nga nenet 326/a/2, 236, 262 të Kodit Penal. Lidhur me masat e sigurimit rezulton se për **3 (tre)** prej tyre është caktuar masa e sigurimit **“arrest në burg” me afat 20 ditor** për **3 (tre) persona masa e sigurimit “arrest në shtëpi”** dhe për **3 (tre) persona, masa e sigurimit “detyrim për paraqitje”.**
 5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Mat**, më datë 20.06.2019, mbi bazën e materialit të dërguar nga Komisariati i Policisë Mat, ka regjistruar **1 (një) procedim penal**, nr. 92 në ngarkim të **10 (dhjetë) personave të arrestuar në flagrancë**, dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestim të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike” të parashikuara nga nenet 326/a/1, 236/2, 262/1 dhe 274 të Kodit Penal. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat aktualisht, po hetohen **2 (dy) persona** me masë sigurimi **“Arrest në burg” me afat 30 ditor; 4 (katër) persona** me masë sigurimi **“Arrest në shtëpi”** dhe **4 (katër) persona** me masë sigurimi **“Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.**
 6. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Kavajë**, ka regjistruar më datë 20.06.2019 **1 (një) procedim penal**, nr.243, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 150, 25 i Kodit Penal, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe “Organizimi dhe pjesëmarrja në

grumbullime e manifestime të paligjshme”, parashikuar nga neni 262/2 i Kodit Penal. Në referim të ngjarjes nga shërbimet e policisë janë **arrestuar 8 (tetë) persona** për të cilët u vendosën masat e sigurimit si më poshtë; për **4(katër) persona** masa e sigurimit “**arrest me burg**”, **2 (dy) persona** me masë sigurimi “**arrest në shtëpi**” dhe **2 (dy) persona** me masë sigurimi “**detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore**”.

7. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Pogradec**, ka regjistruar më datë 29.06.2019 **1 (një) procedim penal** në ngarkim të **2 (dy) personave të arrestuar në flagrancë** për veprën penale “Pengimi i subjekteve zgjedhore”, parashikuar nga neni 325 e 25 të Kodit Penal. Akoma nuk janë dhënë masat e sigurimit nga gjykata.
8. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Dibër**, ka regjistruar më datë 29.06.2019 **1 (një) procedim penal** në ngarkim të **12 (dymbëdhjetë) personave të arrestuar në flagrancë** për veprën penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga nenet 326 dhe 236/2 të Kodit Penal. Akoma nuk janë dhënë masat e sigurimit nga gjykata.
9. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Fier**, ka regjistruar më datë 29.06.2019 **1(një) procedim penal** në ngarkim të **4 (katër) personave, 3 (tre) të arrestuar në flagrancë dhe 1(një) i shpallur në kërkim policor**, për veprën penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor” parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal. Akoma nuk janë dhënë masat e sigurimit nga gjykata.

Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore **Gjirokastrë, Durrës, Berat, Lushnjë, Krujë, Sarandë, Kurbin, Pukë dhe Vlorë, si dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda** kanë njoftuar se deri në këto momente **nuk kanë të regjistruar procedime penale** lidhur me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe çdo shkelje që lidhen me zgjedhjet e 30 qershorit.